

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-115/2014

**Prishtinë/Pristina,
26 Prill 2017**

Në çështjen juridike të:

S. D. në emër të të ndjerës V. M.

Pala ankuese

Kundër

Askush

Pala përgjegjëse ne ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Beshir Islami dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur në lidhje me Kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës-Kolegji i Ankesave të Agjencisë Kosovare të pronave(më tej AKP) GSK-KPA-A-115/2014 I datës 21 Shtator 2016, në seancën e kolegjit me 26 Prill 2017 mori këtë

AKTGJYKIM

Hidhet poshtë si e palejueshme Kërkesa për shqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës-Kolegji i Ankesave të Agjencisë Kosovare të Pronave GSK-KPA-A-115/2014 I datës 21 Shtator 2016 .

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 9 Shkurt 2007, S.D. (në tekstin e mëtejme referohet si: pala ankuese) ka paraqitur një Kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e të drejtës pronësore dhe ri-posedimin shtëpisë me oborr që ndodhet në ngastrën kadastrale nr. 5014, komuna e Prishtinës, me sipërfaqe prej 6 ari e 9 m² (në tekstin e mëtejme referohet si: prona e kërkuar). Ajo shpjegoi se tezja e saj V. M. tani e ndjerë ishte pronare e pronës së kërkuar dhe se e njëjta e kishte humbur posedimin mbi pronën e kërkuar më 13 qershor të vitit 1999 për shkak të rrethanave që ndodhën në vitet 1998/1999 në Kosovë. Ajo pretendon se tezja e ndjerë nuk ka trashëgimtarë të tjerë përveç palës ankuese dhe motrës së saj. Sipas palës ankuese, prona e kërkuar është uzurpuar.
2. Lënda është regjistruar me numrin KPA17959
3. Me 21 Shtator 2016, Kolegji i Ankesave lidhur me vendimet e AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës ka hedhë poshtë si të pa afatshme ankesa e S. D. kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të KPCC/D/R/231/2014, sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA17959, të datës 13 Mars 2014. Në arsyetimin e Aktgjykimit thuhet se mbi bazën e provave të gjetura në shkresat e lëndës ankesa ishte e vonuar.
4. Gjykata Supreme pas vendosjes lidhur me ankesën Aktgjykimin e ka dërguar në AKP dhe mbështetur në dispozitatat e nenit 12.12 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, Sekretaria e Agjencisë me 30 Janar 2017 i kishte dorëzuar Aktgjykimin palës ankuese.

5. Me 20 Mars 2017 S. D. ka kërkuar shqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës-Kolegji i Ankesave të Agjencisë Kosovare të Pronave GSK-KPA-A-115/2014 i datës 21 Shtator 2016.

Arsyetimi ligjor

6. Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se kërkesa për shqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit është e pa lejuar dhe si e tillë duhet hedhur. Në arsyetimin e Aktgjykimit në paragrafin e fundit “**Këshillë ligjore**” është cekur se “në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.
7. Prandaj Gjykata konstaton se Aktgjykimi nuk mund të shqyrtohet prapë sepse këtë e parashohin qartazi dispozitatat ligjore të cekura më lartë dhe për këto arsye Gjykata nuk shqyrtoi fare meritat e kërkesës por vendosi si në dispozitiv.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, Gjyqtar

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it